



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.373/2013

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditesit: () nga te cilin e perfaqeson sipas autorizimit av. nga , kunder te paditurit: () nga , tani me adrese te panjohur te cilin e perfaqeson perfaqesuesi i perkoheshem av. nga , sipas aktvendimit te kesaj gjykate , baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlera e lendes se kontestit; 1.240,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.25.02.2016, jep kete;

AKT GJYKIM

- APROVOHET kerkespadia e paditesit: () nga dhe VERTETOHET se paditesi eshte pronar i palujtshmerise , parc.kat.199-2 me kulture shtepi ne sipërfaqe prej 0.00.61 ha dhe oborr me sipërfaqe prej 0.04.39 ha , ne vendin e quajtur „fsh. - “ e cila evidentohet ne emer te () ZK -

Detyrohen i padituri qe ti njohin kete te drejte paditesit dhe ti lejoj qe paditesi kete palujtshmeri ta regjistroi ne emër te tij pranë Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesi ne padine e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tij ka theksuar se i njeiti ne vitin 1984 me te paditurin kane lidhur Kontrate mbi shitblerjen e palujtshmerise te cekur ne dispozitiv ne shume prej 74.000.000, 00 dinare te cilin qmim

paditesi ne teresi ia ka paguar te paditurit me rastin e kontraktimit . Paditesi eshte mbajtes me mirebesim i kesaj palujtshmerie qe nga shitblerja e gjere me tani mirepo e drejta pronesore nuk eshte e regjistruar ne emer te tij per shkak te nglizhences se paleve kontraktuese .

Paditesi i propozoi gjykates qe te paditurit i cili eshte ne vendbanim te panjohur per paditesin te njejtit ti caktoi perfaqesuesin e perkoheshem.

Ne fjalen perfundimtare i autorizuari i paditesit i propozon gjykates qe padine dhe kerkesepadine ta aprovoj si te bazuar nga se paditesi kete palujtshmeri e ka fituar ne baze te mbajtjes me mirebesim me teper se 20 vite.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Ne baze te propozimit te paditesit e konform nenit 84 al.2 pika 4 si dhe nenit 85 te LPK-es , gjykata me aktvendimin e saj C.nr.373/13 te dt.01.10.2015 , te paditurit te dyte. i caktoi perfaqesuesin e perkoheshem , av. i nga

Perfaqesuesi i perkoheshem i paditurit ne seancen e shqyrtimit kryesor ne fjalen perfundimtare i propozoj gjykates qe gjykata qe te vendos ne baze te rezultatit te provave te zhvilluara dhe ligjit.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi .

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme , dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Qertifikaten e pronesise i te dt. 30.12.2015, Kopjen e planit te dt. 14.01.2016, Ekspertizen e ekspertit gjeodet i te dt.14.01.2016 , Procesverbalin mbi vendshiqim te kesaj gjykate te dt. 25.12.2015, si dhe degjoi deshmitaret : dhe dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga qertifikata e pronesise te sipercekur konstatohet se palujtshmeria tani lendore evidentohet ne emer te paditurit .

Nga Kopja e planit e sipercekur shifet shtrirja ,siperfaqja dhe perkufizimi i palujtshmerise tani lendore .

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertizes gjeodete te sipercekur konstatohet se : palujtshmeria tani lendore shtrihet dhe evidentohet ne parc. Kat te cekura si ne dispozitiv .

Nga skica e situacionit te terenit si dhe kopja e planit te sipercekura shifet shtrirja- siperfaqja si dhe perkufizimi i palujtshmerise tani lendore.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

C nr.373/2013 dt.25.02.2016

**Gjyqtari,
Ragip Kadriu**

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves, e permes kesaje gjykate.